



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.10.2014, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Miratimi i kalendarit të komisionit për periudhën 13 - 30 tetor 2014.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për rindërtim dhe zhvillim (BERZH) për marrëveshjen e huas ndërmjet Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për linjën e kredisë për Agjencinë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave”.
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin për Sistemin Evropian të Institucionit për automjetin dhe lejen e drejtimit (EUCARIS)”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Dashamir Peza, Blendi Klosi, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Tahir Muhedini, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Mark Frroku, Tom Doshi dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Mhill Fufi, Eduard Halimi, Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Edi Paloka, Gent Strazimiri, Arben Ristani, Keltis Kruja, Kastriot Islami, Gjovalin Bzheta, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Milbana Treska – drejtoreshë e Drejtorisë së Borxhit Publik në Ministrinë e Financave.

Toni Gogu – përfaqësues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Nikolin Bërzhiku – përfaqësues i Drejtorisë së Sigurisë Rrugore në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

Maksim Tashi – përfaqësues i Drejtorisë së Sigurisë Rrugore në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit sipas rendit të ditës, ku si pikë të parë kemi miratimin e kalendarit të komisionit për periudhën 13 - 30 tetor 2014.

Ka ndonjë sugjerim, ndonjë kundërshtim? Dakord? Dakord.

Faleminderit!

Si pikë e dytë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për marrëveshjen e huasë ndërmjet Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për linjën e kredisë për Agjencinë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave”.

Fillimisht do të dëgjojmë përfaqësuesit e qeverisë.

Ju lutem, zonja Treska, na bëni një përmbledhje të shkurtër.

Milbana Treska – Ju faleminderit!

Bëhet fjalë për marrëveshjen e garancisë midis Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për linjën e kredisë që do të përfitojë Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Kjo linjë kredie i nevojitet Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, si fonde shtesë, përveç fondeve që ajo ka në dispozicion, në mënyrë që të realizojë funksionin e saj për të mbështetur depozituesit në rast ngjarjeje, gjithmonë në përputhje me ligjin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave tashmë të ndryshuar.

Kjo linjë kredie është siguruar nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim në shumën 100 milionë euro, e cila ka kushte dhe terma që ju i keni në relacion. Janë terma të favorshme. Në përgjithësi konsiderohen terma të butë, *soft law*, në aspektin e menaxhimit të borxhit, sepse ka një normë Euribor plus një marzh 1% dhe komisione të tjera, që kanë të bëjnë me komisionet e angazhimit, të parapagimit ose *consulation fee*-të, që paguhen në këtë rast.

Në lidhje me realizimin e këtij projekti të rëndësishëm, siç e thamë, qëllimet kryesore janë dy: siguri i fondeve shtesë për Agjencinë, për depozituesit dhe, në të njëjtën kohë, siguri edhe i stabilitetit monetar dhe financiar në vend.

Nëpërmjet këtyre fondeve është e mundur që në mënyrë të shpejtë nëpërmjet kësaj linje kredie të sigurohet Agjencia në momentin e duhur për një periudhë të shkurtër për të mbuluar të paktën edhe dy banka të tjera në sistemin bankar në rast ngjarjeje.

Në qoftë se keni më shumë diskutime, përfaqësuesi i Agjencisë, zoti Gogu, mund të përgjigjet.

Fatmir Xhafaj – Nuk ka gjë.

Kaq kishit për pjesën tuaj?

Milbana Treska – Po.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit për shpjegimet tuaja!

Ka ndonjë gjë nga relatori? Zoti Peza?

Dashmir Peza – Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BERZH-it” është shumë i rëndësishëm për sigurimin e sektorit bankar në vend dhe financohet nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim me një kredi prej 100 milionë eurosh, me kushtin që të ketë garanci në Republikën e Shqipërisë.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje Republika e Shqipërisë del garante për të gjitha detyrimet që Agjencia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave kanë marrë përsipër. Për dhënien e kësaj kredie BERZH-i kërkon plotësimin e kushteve të tilla si hyrjen në fuqi të projektligjit që tashmë ka hyrë në fuqi. Nga ana procedurale projektligji është paraqitur për shqyrtim dhe i është propozuar nga Këshilli i Ministrave që është organi kompetent, sipas përcaktimeve të nenit 81 të Kushtetutës dhe shoqërohet me relacionin përkatës që kolegët e kanë përpara.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, në cilësinë e relatorit i propozoj Komisionit për Çështjet Ligjore miratimin e tij dhe kalimin për votim në seancë plenare.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Peza!

Ka pyetje? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ju faleminderit zoti Gogu dhe zonja Treska!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.10.2014, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin për Sistemin Evropian të Institucionit për automjetin dhe lejen e drejtimit (EUCARIS)”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Dashamir Peza, Blendi Klosi, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Tahir Muhedini, Mark Frroku, Tom Doshi dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Mhill Fufi, Eduard Halimi, Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Edi Paloka, Gent Strazimiri, Arben Ristani, Keltis Kruja, Kastriot Islami, Gjovalin Bzheta, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Nikolin Bërzhiku – përfaqësues i Drejtorisë së Sigurisë Rrugore në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

Maksim Tashi – përfaqësues i Drejtorisë së Sigurisë Rrugore në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

Fatmir Xhafaj - Pika e tretë e rendit të ditës është projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin për Sistemin Evropian të Institucionit për automjetin dhe lejen e drejtimit (EUCARIS)”.

Një nga përfaqësuesit e ministrisë duhet të bëjë një përmbledhje shumë të shkurtër, pasi marrëveshja është e njohur publikisht dhe kolegët e kanë pasur në dispozicion me kohë, por mund të paraqisni një prezantim, nëse ka ndonjë gjë të veçantë jashtë relacionit që e shoqëron marrëveshjen.

Nikolin Bërzhiku - Sistemi European i Shkëmbimit të Informacionit për automjetet dhe lejen e drejtimit është një sistem unik, i cili u mundëson fondeve evropiane të shkëmbejnë informacione mbi regjistrimin e mjeteve dhe të drejtuesve të tyre. Kjo bëhet edhe në kuadrin e parandalimit të shkeljeve ligjore që kryen në drejtim të trafikimit të mjeteve. Në këtë kuadër vendi ynë duhet të rrisë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për regjistrimin e të dhënave të automjeteve. Gjithashtu siguron mundësinë e krijimit të një *database*-i me të dhëna teknike, të vendeve të origjinës të mjeteve të importuara apo edhe të lejeve të drejtimit mbi autenticitetin e tyre dhe u krijon procedura më të shpejta të shkëmbimit dhe të njohjes reciproke të lejeve të drejtimit të vendeve të ndryshme. Shqipëria është palë e re kontraktuese, dhe ky traktat bëhet përmes një instrumenti të aderimit dhe depozitohet në qeverinë e Dukatit të Madh të Luksemburgut. Pjesëmarrja në të ka një pagesë, kuotë financiare, e cila përballohet nga drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor që është një institucion me vetëfinancim.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Po, zoti Muçmataj, si relator.

Vexhi Muçmataj - Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji i paraqitur nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë së Punëve të Jashtme synon aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin për Sistemin Evropian të Informacionit për automjetin dhe lejen e drejtimit. Ky sistem u ofron mundësinë vendeve evropiane të shkëmbejnë informacione për regjistrimin e mjeteve dhe drejtuesit e tyre.

Në aspektin ligjor dhe procedural, projektligji është i mbështetur në kërkesat e Kushtetutës, në nenin 121 dhe atë vijues, si edhe në Rregulloren e Kuvendit.

Duke vlerësuar rëndësinë e projektligjit, i propozoj komisionit që ta miratojmë atë dhe ta kalojmë në seancë plenare.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka pyetje?

Po, zoti Lutaj.

Piro Lutaj – Në fakt, do të doja nga specialistët diçka më të kuptueshme për opinionin. Ky është një traktat që bëhet në kuadër të bashkëpunimit me vendet e tjera, por do të doja për arsye të aksesit që marrin vendet respektive, cili do të jetë interesi i qytetarëve shqiptarë për përdorimin e mjeteve dhe të pajisjes me leje aftësie për përdorimin e tyre? Pra, konkretisht, do të ketë më nevojë qytetari shqiptar, që udhëton në këto vende që nënshkruajnë traktatin, për t'u pajisur me një leje qarkullimi tjetër ndërkombëtare ose patentë ndërkombëtare, siç quheshin me termat e vjetër?

Faleminderit, zoti Lutaj!

Nikolin Bërzhiku – Ky sistem ndihmon më shumë në regjistrimin e mjeteve dhe të lejeve të drejtimit kur kanë një mbajtës nga një vend i Bashkimit European. Pra, është në momentin e parë të regjistrimit. Kurse procedurat e qarkullimit të mjeteve tona në vendet e tjera, do të shoqërohen, siç është në konventat e parashikuara, me dokumente të tjera: leje ndërkombëtare e qarkullimit ose ndonjë element tjetër.

Kjo ndihmon shumë në shkurtimin e kohës dhe në shërbimet që u bëhen qytetarëve kur regjistrojnë mjetet e tyre për herë të parë. Shumica e mjeteve në Shqipëri vijnë prej vendeve të Bashkimit European dhe nevojitet një kohë për të verifikuar të dhënat. Po kështu edhe për lejet e drejtimit. Ka shumë qytetarë që kanë përfituar leje drejtimi në vende të huaja dhe kur ka nevojë për shkëmbime apo njohje reciproke, do të ketë procedura më të shpejta.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Fino.

Bashkim Fino – Pyetja e kolegut tim ishte: çfarë përfitojnë qytetarët? Qytetarët nuk përfitojnë gjë me këtë. Me këtë përfiton shteti ynë që regjistron makinat në bashkëpunim me shtete të tjera europiane, nëse është apo jo makinë e vjedhur dhe nëse është apo jo makina në rregull. Megjithatë relatori na tha ta votojmë, do ta votojmë, por nuk fiton gjë qytetari në rastin konkret. Kjo është marrëveshje midis Shqipërisë dhe palëve të treta, të cilat duhet të regjistrojnë automjetet kur janë të rregullta.

Por kolegu bëri një pyetje: konkretisht unë si qytetar çfarë përfitoj nga kjo marrëveshje nëse e votoj, cili është përfitimi? Zero përfitim.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Specialisti mund të japë një shpjegim.

Nikolin Bërxhiku – Për lejet e drejtimit në momentin e konvertimit nga leje drejtimi italiane në shqiptare, qytetari përfiton, sepse me një klikim merret konfirmimi nga pala e vendit tjetër dhe menjëherë i bëhet konvertimi. Dorëzohet patentat italiane dhe merret patentat shqiptare.

E dyta, në momentin që një qytetar do të marrë një mjet të blerë në Shqipëri, mund të pyesë në DPSHTR nëse ky mjet është apo jo i vjedhur. Nëse është i vjedhur, ai nuk e blen dhe nuk regjistrohet.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Hysi ka një pyetje.

Vasilika Hysi – Unë kam dy pyetje lidhur me këtë traktat.

E para, nëse të gjitha vendet e Bashkimit Europian janë pjesë e këtij traktati apo janë vetëm pesë vendet që përmenden në preambulën e këtij traktati?

E dyta, miratimi ose aderimi në këtë marrëveshje ka kosto financiare për qeverinë shqiptare, sepse këtu duhet të merren masa për të mbrojtur të dhënat, për të mos u falsifikuar të dhënat, për të mos u lexuar, kopjuar dhe lidhur ose lidhur me transferimin e të dhënave?

Faleminderit!

Nikolin Bërxhiku – Lidhur me vendet, janë pothuajse të gjitha vendet e Bashkimit Europian. Në faqen e dytë të relacionit janë palët kontraktuese. Pesë vendet janë vende themeluese, por pothuajse janë shumica e vendeve të Bashkimit Europian.

Lidhur me kuotën, ne thamë që ka një pagesë vjetore, e cila ka të bëjë më shumë me shpenzimet e mirëmbajtjes së këtij sistemi. Kurse garancia e mbrojtjes së të dhënave për qytetarët bëhet duke zbatuar direktivën përkatëse të Bashkimit Europian dhe është një nga kushtet e zbatimit të kësaj marrëveshjeje për mbrojtjen e të dhënave. Kjo monitorohet qoftë nga institucionet tona përkatëse, por edhe nga ato të huaja.

Fatmir Xhafaj – Po, urdhëroni!

Nikolin Bërxhiku - Buxheti i shtetit nuk ka asnjë lloj shpenzimi, shpenzimet do t'i bëjë Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit që është me vetëfinancim, që bën edhe regjistrimin e mjeteve dhe konvertimin e lejeve të drejtimit.

Fatmir Xhafaj – Nuk besoj se qëndron këtu vlera e marrëveshjes, kam përshtypjen se është diçka më shumë, është edhe në kuadrin e detyrimeve që kemi ne në raport me vendet e tjera, apo jo.

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Diskutime? Nuk ka. Besoj se ishin të qarta sqarimet edhe me ndërhyrjet e kolegëve.

Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 2 “Hyn në fuqi 15 ditë pa botimit në Fletoren Zyrtare”.

Dakord.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe kjo marrëveshje.

Faleminderit!

Dëshiroj t’i bëj me dije komisionit që nesër mbledhja e komisionit do të jetë në përsëri në orën 11, për shkak se në orën 10:00 do të jetë ambasadorja e Bashkimit Europian për të prezantuar progresraportin këtu në Kuvend.

Në orën 11:00 është Kodi Rrugor, prezantimi në parim, pastaj pika e dytë është Kodi i Procedurave Administrative. Me kërkesë të Delegacionit Europian dhe të SIGMA-s, një ekspert gjerman, që është marrë me këtë çështje, ka kërkuar të dëgjohet në komision nesër. Kjo është edhe një arsye tjetër pse është në këtë orar. Kështu që do të kërkoja prezencën e të gjithë kolegëve në orarin e caktuar.

Mirupafshim!

MBLEDHJA MBYLLET

